



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 3/14

Prishtinë, më 24.12.2014, ora 10:30

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Bojan Mitić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jakup Krasniqi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Avdullah Hoti-Ministër i Financave, Agim Krasniqi-Drejtor i Departamentit të Buxhetit Qendror në MF, Rustem Berisha – Deputetë, Bali Muharremi – Deputetë Lumni Murati-ZPRK, Petrit Hysaj-OSBE, Jetmir Bajra –KDF, Argjent Zeqiria-Ass i GP AAK. Ramadan Islami nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - sot do të shqyrtojmë pjesën tabelare të projektligjit, respektivisht kërkesat buxhetore që i janë drejtuar komisionit. Po ashtu do të shqyrtojmë amendamentet e deputetëve dhe grupeve parlamentare. Paraprakisht, siç jemi dakorduar, do ta dëgjonim propozimin e Ministrisë së Financave lidhur me nenin 9.2 të pjesës tekstuale të projektligjit, që ka të bëjë me financimin e RTK-së.

Avdullah Hoti – propozimi i Ministrisë së Financave, lidhur me nenin 9.2, është si vijon:

2. Financimi i RTK-së bëhet:

2.1. për vitin fiskal 2015, RTK-së i ndahen 0.7% (zero pikë shtatë përqind) të hyrave nga Buxheti i Kosovës, duke përjashtuar të hyrat nga proceset e privatizimit, të hyrat e njehershme për Buxhetin e Kosovës dhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe lokal.

2.2. për periudhën Janar-Maj 2015, kjo ndarje bëhet në përputhje me paragrafin 4. të nenit 21 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, ndërsa për periudhën e mbetur të vitit 2015 ndarja bazohet në këtë ligj.

Visar Ymerit - është një qështje që po e trajtojmë në mënyrë të padrejtë, sepse edhe pas skadimit të kohës së financimit të RTK-së nga buxheti i Kosovës, me këtë propozim ende po vazhdojmë ta trajtojmë sikurse organizatat tjera buxhetore. Unë e kam konsultuar Ligjin e RTK-së dhe aty thotë se ka qenë përgjegjësi e menaxhmentit të RTK-së, gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit që të bëjë propozimin për financimin afatgjatë dhe që RTK-ja nuk e ka bërë kurrë. RTK është themeluar nga Kuvendi dhe Kuvendi është i obliguar drejtpërsëdrejti të financon atë. Por, unë e kundërshtoj këtë mënyrë të financimit, siç u propozua nga ministria, për dy arsye: njëra nuk kemi të dhëna se si do ti shpenzojë këto para RTK-ja, dhe si janë përgatitur dhe shqyrtuar kërkesat buxhetore të RTK-së dhe e dyta nuk kemi raport transparent të asaj si ka funksionuar dhe menaxhuar ky medium me paranë publike.

Kryetari – RTK-ja është financuar nga Kuvendi dhe nga administrata dhe Kuvendi ka pas shumë vërejtje për shkak të procedurave e ngarkesave të mëdha në menaxhimin e buxhetit të RTK-së, dhe kemi bërë një zgjidhje tjetër dhe konsideroj që ajo ka funksionuar. Unë konsideroj që duhet pritura raportet e shpenzimeve dhe pasi ti kemi këto raporte, do të ngrisim debate dhe të gjejmë mënyrën më të mirë se si do të bëhet menaxhimi në këtë institucion. Deri atëherë ne nuk mund të bëj ndonjë zgjidhje tjetër.

Bardhyl Meta – pjesën e parë të financimit duhet ta rregullojmë konform Ligjit të RTK-së. Në fakt, ligji thotë se brenda tri vitesh, menaxhmenti është dashur të sjell një model të propozimit për financim afatgjatë të RTK-së, por edhe qeveria dhe këto të dyjat kanë dështuar në këtë aspekt. Duhet me pas një debat në seancë për RTK-në, duke përfshijë çështjen e financimit, por edhe çështjet tjera, se çfarë ka ngja me punësimet gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014. Pra duhet që Parlamenti dhe grupet profesionale të debatojnë se si do të financohet në vazhdim RTK. Prandaj, po kërkoj se para muajit prill, RTK-ja ta sjellë biznes planin për vitin 2015 dhe 2016 dhe ta dimë se sa mjete i duhen në bazë të nevojave të planifikuara dhe jo me automatizëm të ndahen 0.7%, si gjithmonë.

Donika Kadaj-Bujupi - i kam dy kërkesa, e para këtu po diskutohet për dokumentin më të rëndësishëm siç është buxheti dhe mungojnë mediat, dhe prej mëngjesit jam në konsultim me koordinatorët e komisionit edhe me zyrën për media, dhe nuk e kanë pas dritën e gjelbërt për me dërgue ftesën për media. Nuk e di se çka është më e rëndësishme për opinionin publik, se ma me e ditë se kah po shkojnë taksat e tyre, prandaj e bëjë si vërejtje, e herave tjera ta keni parasysh që të njoftohen mediat për takimet e komisionit. Sa i përket financimit të RTK-së, po e konsideroj se këtë që e thanë kolegët, ne duhet ti ndajmë mjete në 3 mujorin e parë, sepse nuk kemi bazë ligjore me i aloku mjetet për një vit, dhe unë mendoj se duhet të veprohet sipas ligjit.

Kryetari - ne kemi një mbledhje standarde dhe të hapur dhe kush ka interes le të vie, por unë konferencë nuk kam. Ftesa për mbledhje është e dërguar në internet dhe mediat po të ishin të interesuara do të vinin.

Donika Kadaj-Bujupi - edhe një herë po e ritheksoj shkurt se sot janë ftuar vetëm deputetët dhe jo mediat. Këta që janë të pranishëm i kam ftuar unë. Mediat duhet të njoftohen dhe të jenë të pranishme në takimet e komisionit, duhet me pas transparencë dhe duhet me i ftue mediat, sepse është edhe në interes për juve si kryetar, po ashtu është edhe ne interes të deputetëve.

Kryetari - kjo nuk është vërejtje sepse stafi më njoftoj se ftesa dhe rendi i ditës është publikuar në internet.

Besa Gaxherri – tashmë u theksua se deri në muajin maj, RTK-ja financohet sipas Ligjit të RTK-së dhe deri në rishikimin e buxhetit, menaxhmenti duhet të dërgojë propozimet konkrete për mënyrën e financimit afatgjatë, ne të kundërtën, RTK nuk mund të financohet nga buxheti i Kosovës, siç është financuar deri më tani.

Kryetari – RTK-ja e ka bërë propozimin e vetë në komisionin funksional dhe kjo çështje ka mbetur aty. Në raportin financiar që do të dërgojë RTK apo edhe në bazë të planit të punës, do ti kërkojmë që të na raportojë në komision për çështje financiare dhe do ta diskutojmë me ata dhe do ti marrim vendime tjera.

Pas diskutimeve dhe Kryetari konstatoi se Komisioni, me tetë vota Për, dy Kundër (Visar Ymeri dhe Donika Kadaj-Bujupi) dhe asnjë Abstenim, miratoi propozimin për ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 9 të Projektligjit të Buxhetit për vitin 2015, si në vijim:

2. Financimi i RTK-së bëhet:

2.1. për vitin fiskal 2015, RTK-së i ndahen 0.7% (zero pikë shtatë përqind) të hyrave nga Buxheti i Kosovës, duke përjashtuar të hyrat nga proceset e privatizimit, të hyrat e njëhershme për Buxhetin e Kosovës dhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe lokal.

2.2. për periudhën Janar-Maj 2015, kjo ndarje bëhet në përputhje me paragrafin 4. të nenit 21 të Ligjit nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, ndërsa për periudhën e mbetur të vitit 2015 ndarja bazohet në këtë ligj.

Kryetari – theksoi se në vazhdim do të shqyrtohen kërkesat dhe amendamentet që janë drejtuar komisionit.

Safete Hadergjona – e kam vërejtura se po vazhdon praktika e dërgimit të kërkesave nga të gjitha institucionet dhe unë mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet me Rregulloren e Kuvendit, ku do të përcaktohet se kush mund të dërgojë kërkesa në komision dhe mos të jemi nën presion të kërkesave të gjithkujt. Ne po ashtu kemi vërejt se edhe amendamentet nuk përmbushin kushtet teknike dhe unë kërkoj se duhet të mbahet një trajnim për deputetët se si duhet të hartohen amendamentet, që kanë të bëjnë me buxhetin. Nëse një deputet e bënë një amendament duhet të bëjë të qartë se çka po kërkon, duhet ta përcaktoj në cilën vijë buxhetore parashihet futja e projektit të cilin e ka si amendament edhe në cilin program do ti merr mjetet.

1.1. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Institucionit të Avokatit të Popullit për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – sqaroi shkurtimisht përmbajtjen e kërkesës së IAP-së, pjesën e kërkesës që është përfshirë nga qeveria në projektbuxhet, dhe atë që nuk është përfshirë.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahen kërkesat buxhetore të Institucionit të Avokatit të Popullit.

1.2. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - njoftoi shkurtimisht me kërkesat e AMKM, për vitin 2015, që kanë të bëjnë me rritjen e numrit të të punësuarve prej 10 (1 drejtor i departamentit, 3 ciceronë dhe 6 roje), ndarjen e buxhetit shtesë për paga dhe mëditje prej 125,910.49 euro, për mallra dhe shërbime 10,000 euro, për komunal 35,750 euro dhe për investime kapitale 5 milion euro. Janë paraqitur edhe lista e projekteve dhe shumat e caktuara që duhet të kalojnë në Agjenci.

Latif Gashi - theksoi se ne dimë se ky agjension është i ri dhe nuk ka arrit me u kompletue sa duhet. Prandaj, kërkesat që ka bërë ky agjencion duhet trajtuar me kujdes. Ne kemi diskutuar edhe vitin e kaluar për projektet kapitale, që janë menaxhuar nga ministria e ambientit. Janë disa kërkesa të arsyeshme dhe të nevojshme, siç është rasti për ciceronët. Ne e dijm së në Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, ciceronët a punojnë mbi baza vullnetare. Ne po flasim për projektet siç janë komplekset memoriale që janë që kushtojnë mira euro dhe aktualisht janë pa përkujdesje dhe në mëshirën e zotit. Prandaj, çështja e ciceronëve është e domosdoshme. Është agjencion që e ka themeluar Kuvendi dhe kemi përgjegjësi për ndarjen e buxhetit për funksionimin e tij.

Safete Hadergjonaj - ne si komision kur është miratuar ligji për këtë agjenci, kemi qenë kundër që agjencia të themelohet si e pavarur. Por, Kuvendi e ka miratuar ligjin, dhe tani është përgjegjësi e Kuvendit që të kujdeset për financimin e saj. Unë mendojë që ciceronët që janë të angazhuar në Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, një vend që vizitohet shumë, por duke mos nënvlerësuar as komplekset tjera memoriale, duhet me qenë punëtor të trajtuar institucionalisht dhe me pas pagë nga buxheti i Kosovës, dhe në këtë rast duhet të jenë pjesë e agjencisë dhe agjencia të merr përgjegjësinë për ata punëtor.

Visar Ymeri – çështjen e moskujdesit të komplekseve memoriale nga qeveria e kaluar, e kemi diskutuar edhe më herët në Kuvend, dhe kjo nuk është problem i vetëm një viti. Ne po diskutojmë kërkesën për numrin e punëtorëve që është i domosdoshëm për këtë agjenci, por unë konsideroj se është dashtë me u diskutue edhe nëpër komisione tjera, për të parë arsyeshmërinë dhe pastaj në komisionin për buxhet dhe financa.

Latif Gashi - kjo qeveri që shkoj e që është prapë i ka ndërtuar këto komplekse memoriale por disa agjensione tjera nuk i kanë proceduar me kohë këto kërkesa, andaj kanë lindur këto probleme. Ne jemi këtu që ti shqyrtojmë në mënyrë racionale këto kërkesa.

Avdullah Hoti - propozimi im është që të përkrahim kërkesën për ciceron dhe për roje, dhe të zvoglojmë numrin e stafit të ministrisë së ambientit dhe ti dërgojmë ne këtë agjension.

Latif Gashi – nëse themi se ministria e ambientit i transferon disa punëtorë ne kompleksin memorial, nuk ndodh kjo. Mendojë, se qeveria duhet të jetë e gatshme të ndaj buxhet, për dy ciceron në kompleksin Adem Jashari dhe një të Zahir Pajaziti dhe për rojtarët dhe kjo duhet të rregullohet me këtë ligj.

Rrustem Berisha – prezantojë amendamentin e tij, që kanë të bëjë me kërkesat për Projektin Kompleksi Memorial “Beteja e Koshares”. Shpjegojë për fillimin e implementimit të projektit në fjalë ku deri më tani tha se i gjithë organizimi i projektit është bërë përmes ministrisë së ambientit dhe prej 1 janarit i gjithë projekti duhet të kalojë në agjenci. Ky projekt arrin vlerën prej 4,174,000 euro që është miratuar prej qeverisë, dhe është viti i tretë dhe duhet të përfundojë projekti. Për projektin në ministrinë e ambientit janë paraparë 150,000 euro dhe këto mjete janë bartur si obligim në vitin 2015 dhe nuk ka asnjë cent të ndara, për me vazhdue projekti.

Latif Gashi – e kemi kompleksin memorial që është punë në vazhdimësi nga ministria e ambientit për Betejën e Koshares, ku një fazë të punimeve e ka krye ministria dhe tjetra është bartur në agjenci. Nga kërkesa e agjencisë e kuptuam se nuk ka buxhet dhe tani shtrohet pyetja kush me i krye këto obligime dhe definitivisht janë çështje për tu diskutuar. Të njëjtin problem e kemi në zonën operative të llapit në fshatin Penuh që ka të bëjë me kompleksin “Dëshmorët e Kombit”, që ka qenë një donacion prej një donatori dhe ku shteti ka dhënë 50,000 euro, dhe projekti ka mbetur ashtu i papërfunduar.

Kryetari – puna e projektit të Koshares dhe përkushtimi jonë asnjëherë nuk ka munguar. Këtu nuk është vetëm një kërkesë, por janë pesë kërkesa tjera të ndryshme për investime kapitale që kanë të njëjtin qëllim. Nëse qeveria e ka prurë një vendim për financimin e pjesëve të pakryera, le të gjejë burimin e ti ndaj mjetet.

Safete Hadergjona - ne kemi shumë projekte të përfshira në buxhet, por nuk janë projekte me urgjencë për momentin, në krahasim me këto që po flasim. Unë e ndjej veten keq që trupat e dëshmorëve ende nuk pushojnë në varr, dhe më prioritet prej të gjithave në këtë moment është me u kthye kufomat në vend të vetin. Për rregullimin e financimit të agjencioneve të pavarura që i raportojnë Kuvendit, nuk është kompetente as ministria e as qeveria, por Kuvendi. Madje, sipas ligjit, kërkesat e agjencive të pavarura dërgohen në ministrinë e financave, dhe nëse janë më të larta se kufijtë buxhetor, ministria nuk mund të ndërhyjë, përveç se të shpreh opinionin e saj, dhe duhet ti përfshijë ashtu siç janë bërë në projekt-buxhet dhe Kuvendi, është ai që vendos përfundimisht për buxhetin e këtyre agjencive.

Rrustem Berisha- sa i përket kërkesave të paraqitura në amendament, janë kërkuar 50,000 euro për projektin Kompleksi “Beteja e Koshares”, që është realizuar nga ministria e ambientit, 800,000 euro mjete shtesë për vazhdimin e projektit të Kompleksit “Beteja e Koshares” që duhet të bëhet nga agjencia dhe 500,000 euro për financimin e rrugës.

Latif Gashi - unë mendoj që deri në rishikim të vendosim një shumë të mjeteve në projektin dhe rrugën, që të mbetet projekti me kod të veçantë, pastaj të shikohet mundësia e ndarjes së mjeteve për kryerjen e këtyre projekteve. Po ashtu, e vlerës së njëjtë është edhe ndarja e mjeteve për projektin në Penuhë, në mënyrë që trupat e dëshmorëve të mos qëndrojnë në male dhe therra dhe të vendosen në vendin e vetë në mënyrë dinjitoze.

Avdullah Hoti - ne propozojmë që të ndahen 50,000 euro për projektin Kompleksi “Beteja e Koshares”, në ministrinë e ambientit, dhe 200,000 euro për vazhdimin e projektit Kompleksi “Beteja e Koshares”, në kuadër të agjencisë, dhe në rishikimin e buxhetit të shqyrtojmë kërkesën në tërësi dhe të planifikojmë realizimin e projektit.

Pas sqarimeve të kërkesës, diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Rekomandohet ndryshimi i Projektbuxhetit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale për vitin 2015, si në vijim:

- rritet numri i punëtorëve për 2 (një ciceron për Memorialin “Adem Jashari” dhe një ciceron për Memorialin “Kulla e Zahir Pajaziti”) si dhe ndarja e mjeteve shtesë buxhetore në paga dhe mëditje për këta dy punëtorë, në shumën prej 8,400€,
- shtohet projekti i ri kapital dhe ndarja e mjeteve buxhetore prej 200,000€ - Vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial “Beteja e Koshares, dhe
- shtohet projekti i ri kapital dhe ndarja e mjeteve buxhetore prej 50,000€ “Memorialet e dëshmorëve të UÇK-së Penuhë – Podujevë.

1.3. Shqyrtimi i kërkesës së parë buxhetore, dt. 15.12.2014 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - ministria e arsimit ka kërkuar transferim e 11 pozitave nga disa komuna: prej Komunës së Gjilanit 4, nga Ferizaj 1, Lipjani 1, Mitrovica 1, Shtimja 1 dhe Prishtina 3 pozita, dhe këta punëtorë të

barten në ministri. Ministria arsyeton kërkesën se mjetet buxhetore janë në kuadër ministrisë, vetëm se numri i punëtorëve duhet bartur nga komunat e lartpërmendura.

Agim Krasniqi - kjo çështje është dashtë të rregullohet mes ministrisë dhe komunave. Ne dimë se sipas ligjit të financave të pushtetit lokal, buxhetin e komunave e miraton kuvendi komunal, sipas formulës së granteve dhe është problem me e ndryshue buxhetin dhe me ba këtë transferë.

Pas sqarimeve të kërkesës dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Përkrahet kërkesa buxhetore, dt. 15.12.2014, e MASHT-të, si në vijim:

1. MASHT-nën-programi me kod 908 Arsimi për fëmijët me nevoja të veçanta në Tabelën 3.1 numri i punonjësve prej 197 ndryshon në 208 punonjës.
Zvogëlohet numri i të punësuarve në Komunat në vijim:
 - Nga Organizata buxhetore, Komuna e Gjilanit, Nën-programi 93780 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 1249 ndryshohet në 1245 punëtor;
 - Nga Organizata buxhetore, Komuna e Ferizajt, nën-programi 93930 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 1313 ndryshohet në 1312 punëtor;
 - Nga Organizata buxhetore, Komuna e Lipjanit, Nën-programi 93060 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 824 ndryshohet në 823 punëtor;
 - Nga Organizata buxhetore, Komuna e Mitrovicës Nën-programi 93630 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 914 ndryshohet në 913 punëtor;
 - Nga Organizata buxhetore, Komuna e Shtimes, nën-programi 93180 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 367 ndryshohet në 366 punëtor;
 - Nga Organizata buxhetore, Komuna e Prishtinës, nën-programi 93150 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 2059 ndryshohet në 2056 punëtor.

1.4. Shqyrtimi i kërkesës së dytë buxhetore, dt. 19.12.2014 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - në kërkesën e dytë, është kërkuar që buxheti i disa shkollave të kompetencës nga 5 komuna, të kalojë në Ministri, respektivisht në Agjensionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional. Ministria ka arsyetuar se është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit dhe rrezikojnë të humbasin donatorin serioz GIZ- në, n rast se nuk bëhet ky transfer. Është thënë se nuk është kosto e re buxhetore.

Safete Hadergjonaj – ministria e ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit me të gjithë kryetarët e këtyre 5 komunave dhe kjo ka të bëjë me shkollat e kompetencës, që mjete buxhetore të barten nga këto komuna në kuadër të ministrisë, respektivisht në Agjensionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional.

Agim Krasniqi – fillimisht është mirë ta dini se agjensioni është formuar pa procedurë ligjore, është arritur marrëveshja pa shikuar përgjegjësitë dhe kompetencat. Edhe nëse merren punëtorët për një vit nga komunat, vitin tjetër nuk mundet sepse është formulë e ndarjes së buxhetit për komunat, sipas ligjit.

Safete Hadergjonaj- ne e kemi kërkesën dhe e shohim se në bazë të cilit nen është themeluar ky agjencion, dhe në buxhetin e Kosovës, figuron vija buxhetore për këtë agjencion, dhe unë kisha propozuar që ta kalojmë këtë kërkesë, pasi që edhe shtim të buxhetit nuk ka.

Pas sqarimeve të kërkesave dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Përkrahet kërkesa buxhetore, dt. 19.12.2014, e MASHT-të, si në vijim:

2. Nën-programi me kod 981-Investimet kapitale në arsimin parauniversitar në Tabelën 3.1 shuma prej 7,158,000€ në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale, ndryshohet në shumën 7,558,000€.

15.1. Nën-programi me kod 975 – Agjensioni Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Tabelën 3.1 numri i punëtorëve nga 6 ndryshohet në 495 punëtor, kategoria e pagave dhe mëditjeve shuma prej 45,042€ ndryshon në shumën 2,855,479€, kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 60,000 ndryshon në shumën 205,860€, kategoria e shpenzimeve komunale shuma prej 1,500 nuk ndryshon. Ky ndryshim ndodhe për shkak të bartjes së SHM Shtjefan Gjeqovi, nga K.K Prishtine në MASHT, 11 Marsi, K.K Prizren në MASHT, dhe 4 Qendrat e Kompetencës (Ferizaj, Malishevë, Skenderaj dhe Prizren) në MASHT.

15.2. Nga Organizata buxhetore, Komuna e Prishtinës, Nën-programi 94350 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 816 ndryshohet në 725 punëtor, kategoria e pagave dhe mëditjeve shuma prej 4,255,317€ ndryshon në shumën 3,689,577€, kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 500,000€ ndryshon në shumën 473,140€.

15.3. Nga Organizata buxhetore, Komuna e Ferizajt, Nën-programi 95130 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 490 ndryshohet në 420 punëtor, kategoria e pagave dhe mëditjeve shuma prej 2,956,130€ ndryshon në shumën 2,560,151€, kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 101,045 ndryshon në shumën 86,275€.

15.4. Nga Organizata buxhetore, Komuna e Malishevës, Nën-programi 94560 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 213 ndryshohet në 132 punëtor, kategoria e pagave dhe mëditjeve shuma prej 1,321,772€ ndryshon në shumën 866,261€, kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 45,571 ndryshon në shumën 13,761€.

15.5. Nga Organizata buxhetore, Komuna e Skenderajt, Nën-programi 94860 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 231 ndryshohet në 181 punëtor, kategoria e pagave dhe mëditjeve shuma prej 1,290,500€ ndryshon në shumën 1,007,081€, kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 70,000 ndryshon në shumën 59,130€.

15.6. Nga Organizata buxhetore, Komuna e Prizrenit, Nën-programi 94470 në Tabelën 4.1 numri i punëtorëve nga 570 ndryshohet në 373 punëtor, kategoria e pagave dhe mëditjeve shuma prej 3,540,062 € ndryshon në shumën 2,430,274 €, kategoria e mallrave dhe shërbimeve shuma prej 325,647 ndryshon në shumën 264,097 €.

1.5. Shqyrtimi i kërkesës së tretë buxhetore, dt. 18.12.2014, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – shkurtimisht sqaroi përmbajtjen e kërkesës së ministrisë për mjete buxhetore shtesë për projekte kapitale.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa e tretë buxhetore, dt. 18.12.2014, e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

1.6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – njoftoi anëtarët me përmbajtjen e kërkesave të ministrisë së shëndetësisë, për mjete shtesë buxhetore të kërkuara për të gjitha kategoritë ekonomike dhe për rritjen e numrit të të punësuarve.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahen kërkesat buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë.

1.7. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Bojan Mitic – buxheti i paraparë për vitin 2015 për Ministrin për komunitete dhe kthim është paraparë në shumë prej 6 milion euro për investime kapitale. Kërkesa e ministrisë është që 3 milion euro të parapara për bashkëfinancim me komunat në Veri të Mitrovicës, të mbeten në ministri për investime kapital, dhe që programi 495 (0130) të riformulohet në Projektin për komunitete. Përveç kësaj jemi marr vesh që buxheti të rritet në 7 milion euro.

Agim Krasniqi - mbi bazën e marrëveshjes politike qeveria është dashur ti ndaj 15 milion euro për 4 komunat e Mitrovicës veriore. Në mesin e këtyre 15 milionëve, ministria për kthim i kërkohet ti ndaj 3 milion euro që të investoj në pjesën veriore. Ajo që tha edhe ministri, marrëveshja është me mbet kështu siç është, dhe me iu nda ministrisë 400,000 euro shtesë.

Pas sqarimeve të kërkesës dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa buxhetore e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

1.8. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - kërkesa është për ndarjen e 900,000 eurove dhe ka të bëjë me bashkëfinancim me IPA projektet.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa buxhetore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

1.9. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statutit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politik për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - kërkesa është të ndahen mjete për komisioni për njohjen e statutit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politik, prej 90,000 euro.

Latif Gashi – komisioni qeveritar për njohjen e statutit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politik edhe ose ka punuar, nuk ka është paguar fare dhe mendojë se duhet t’iu ndahet një shumë.

Kryetari - për ish të burgosurit politike edhe ish të përndjekjet politik janë të ndara mjetet buxhetore, dhe prej asaj shume është dashur të paguhet komisioni.

Pas sqarimeve të kërkesës dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa buxhetore e Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statutit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politik.

1.10. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Federatave të Sindikatave të Pensionistëve dhe të Moshuarve të Kosovës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – mendojë qe ne nuk mund ta plotësojmë këtë kërkesë për mjete shtesë.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahen kërkesat buxhetore të Federatës së Sindikatave të Pensionistëve dhe të Moshuarve të Kosovës.

1.11. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Ismet Krasniqi – sqaroi se kërkesa ka të bëjë me ridestinimin e mjeteve. Për vitin 2015 për paga e mëditjet për deputetë e legjislaturës së IV-të, janë paraparë 930,000 euro, mirëpo atyre ju skadon mandati me 1 maj 2015. Prandaj, kërkesa jonë është që shuma e prej 599,628€ euro nga kjo kategori të ridestinohet si në vijim: 135,000 euro të shpërndahen në mallra dhe shërbime për deputetët, shuma prej 295,850 euro për mallra e shërbime për administratën, shuma prej 33,150 euro për shpenzime komunale për administratën, shuma prej 126,679 euro ndahen për paga dhe mëditje për stafin mbështetës politik, dhe shuma prej 8,199 euro ndahen për mallra dhe shërbime për stafin mbështetës politik. Këto janë kërkesa për ridestinim, ndërkaq kemi edhe një kërkesë për një investim kapital prej 160,000 euro i cili mund të jetë edhe në rishikim të buxhetit.

Visar Ymeri - unë po flas prej tekstit e jo tabelës, dhe në pikën 3 thuhet se për iniciativën e re kërkohen 100,000 euro, për blerjen e pajisjeve mobile për deputetët e Kuvendit. Për çfarë është fjala?

Ismet Krasniqi - ne e kemi pas një tender që për çdo fillim vit të legjislaturës, deputetët pisen më laptop, pra 120 deputet dhe 10 laptop shtesë rezervë në rast humbje apo prishje të tyre. Malli i ardhur para dy javësh është kthyer mbrapa dhe kjo ka mbet dhe është iniciativë e re në 2015. Në këtë vit startojmë me E-Parlamentin dhe kjo është një nga ato pajisjet që krijon lidhshmërinë, furnizim për çdo legjislaturë.

Pas sqarimeve të kërkesës dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Përkrahen kërkesat për ndryshime brenda buxhetit të Kuvendit të Kosovës, si në vijim:
 - Nën-Programi- Anëtarët e Kuvendit me kod 101, në Tabelën 3.1 shuma prej 4,301,383€ ndryshohen në shumën prej 3,701,755 për kategorinë e pagave dhe mëditjeve
 - Nën-Programi- Anëtarët e Kuvendit me kod 101, në Tabelën 3.1 shuma prej 429,250€ ndryshohen në shumën prej 565,000€ për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
 - Nën-Programi- Personeli/Administrata e Kuvendit me kod 102, në Tabelën 3.1 shuma prej 849,150€ ndryshohen në shumën prej 1,145,000€ për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
 - Nën-Programi- Personeli/Administrata e Kuvendit me kod 102, në Tabelën 3.1 shuma prej 187,850€ ndryshohen në shumën prej 221,000€ për kategorinë e shpenzimet komunale.
 - Nën-Programi- Stafi mbështetës politik me kod 158, në Tabelën 3.1 shuma prej 39,801€ ndryshohen në shumën prej 48,000€ për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.
 - Nën-Programi- Stafi mbështetës politik me kod 158, në Tabelën 3.1 shuma prej 485,521€ ndryshohen në shumën prej 612,200€ për kategorinë e pagave dhe mëditje.
 - Nën-Programi- Stafi mbështetës politik me kod 158, në Tabelën 3.1 numri i punëtorëve prej 36 ndryshohet në 42.

1.12. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të INFRAKOS për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – kërkesa është për mjete shtesë për 1,200,000 euro.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesat buxhetore të INRAKOS.

1.13. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Ministrisë së Infrastrukturës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – kemi një kërkesë nga ministria e infrastrukturës që kërkon që disa projekte me iu zvoglue, e me iu lejue një kod të ri për shtresim të rrugëve nacionale.

Avdullah Hoti – përderisa kërkesat nuk prekin totalin e shpenzimeve kapitale, mund të shtojmë kode të reja e mund të heqim shuma prej disa kode tjera edhe të shtojmë kod të ri, pra të bëjmë rregullime të brendshme.

Pas sqarimeve të kërkesës dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Përkrahet kërkesa buxhetore e Ministrisë së Infrastrukturës për transfere të brendshme të projekteve kapitale, brenda buxhetit të ministrisë, e cila do të bëhet në formë të amendamentit të komisionit.

1.14. Shqyrtimi i kërkesës së parë buxhetore, dt. 10.11.2014 të Komunës së Klllokotit-Verbovcit për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa është për ndarjen e mjeteve shtesë për investime prej 150,000 euro, mallrave dhe shërbimeve 100,000 euro, komunal 50,000 euro dhe subvencione 50,000 euro.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Bojan Mitic), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahen kërkesat buxhetore, dt. 10.11.2014, të Komunës së Klllokotit-Verbovcit.

1.15. Shqyrtimi i kërkesës së parë buxhetore dt. 11.12.2014 të Komunës së Obiliqit për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se Komuna e Obiliqit, ka dërguar dy kërkesa. Kërkesa e parë ka të bëjë me ndarjen e mjeteve shtesë buxhetore për investime kapitale në shumë prej 254,800 euro.

Donika Kadaj-Bujupi – kërkesa e komunës është për shtëpinë e pleqve, për një mjek të përgjithshëm dhe një teknik. Shtëpia është donacion dhe nëse nuk e dërgojmë një mjek e një teknik, do ta degradojmë atë shtëpi edhe do të mbetet e pashfrytëzuar.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Donika Kadaj-Bujupi), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesat e parë buxhetore, dt. 11.12.2014, e Komunës së Obiliqit.

1.16. Shqyrtimi i kërkesës së dytë buxhetore dt. 11.12.2014 të Komunës së Obiliqit për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - në kërkesën e dytë kërkon 15 pozita të reja dhe një shumë prej 300,000 euro, në paga dhe mëditje.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Donika Kadaj-Bujupi), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahen kërkesat e dytë buxhetore, dt. 11.12.2014, e Komunës së Obiliqit.

1.17. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komunës së Leposaviqit për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - sqaroi se kërkesa është për rregullime brenda buxhetit të komunës.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Përkrahet kërkesa që në Komunën e Leposaviqit me kod organizativ 641, bëhen ndryshime në tabelën 4.2, programi Shërbime Publike Mbrojtja Civile dhe Emergjente (181), nga nën-programi infrastrukturë publike (18181) Projekti “Bashkëfinancim me projektet kapitale” me kod (41702) në shumë prej 913,371 euro, kalon në nën-programin Infrastrukturë rrugore (18021).

1.18. Shqyrtimi i kërkesës së parë buxhetore dt. 19.12.2014 të Komunës së Mamushës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - sqaroi se kërkesa është për rregullime brenda buxhetit të komunës.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Përkrahet kërkesa që në Komunën e Mamushës me kod organizativ 626, bëhen ndryshime në tabelën 4.2, nga programi Planifikim Zyra e Kryetarit (160), nën-programi (16014), projekti “Paisje të IT”, shuma prej 5,000 euro, të kalojë në programin Administratë dhe Personel (163) nën-programi Administrata (16314), në projektin “Pajisje të IT”, kodi i projektit (85757), në shumën prej 5,000 euro, sipas buxhetit të aprovuar në Kuvendin Komunal për vitin 2015.

1.19. Shqyrtimi i kërkesës së dytë buxhetore dt. 22.12.2014 të Komunës së Mamushës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa e dytë e komunës së Mamushës, ka të bëjë me ndarjen e mjeteve buxhetore shtesë për mallra dhe shërbime prej 31,000 euro, shpenzime komunale prej 2,500 euro dhe subvencione dhe transfere prej 2,500 euro.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Fikrim Damka), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa e dytë buxhetore, dt. 22.12.2014, e Komunës së Mamushës.

1.20. Shqyrtimi i kërkesës së parë buxhetore dt. 11.08.2014 të Komunës së Shtërpçës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa është për ndarjen e mjeteve shtesë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe rritjen e numri të punëtorëve për një.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Bojan Mitic), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa e parë buxhetore dt. 11.08.2014, e Komunës së Shtërpçës.

1.21. Shqyrtimi i kërkesës së dytë buxhetore dt. 19.12.2014 të Komunës së Shtërpcës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa është për rregullime brenda buxhetit të komunës.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Përkrahet kërkesa që në Komunën e Shtërpcës me kod organizativ 655 bëhen ndryshime në tabelën 4.2, në programi Planifikim Urban dhe Mjedis (660), nga nën-programi Planifikim Hapësinor dhe rregullativ me kod (66160), ndryshohet me nën-programin Planifikim mjedisor dhe inspeksion (66660), sipas buxhetit të aprovuar në Kuvendin Komunal për vitin 2015.

1.22. Shqyrtimi i kërkesës së tretë buxhetore dt. 23.12.2014 të Komunës së Shtërpcës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa ka të bëjë me ndarjen e mjeteve shtesë në vlerë prej 500,000 eurove për projektin “ndërtimi i stadiumit për futboll të madh në Livad të Komunës së Shtërpcës.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Bojan Mitic), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa e tretë buxhetore dt. 23.12.2014, e Komunës së Shtërpcës.

1.23. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Suharekës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa komunës së Suharekës është pranuar sot nga komisioni dhe ka të bëjë me ndarjen e mjeteve shtesë buxhetore për projekte kapitale.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahen kërkesat buxhetore e Komunës së Suharekës.

1.24. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komunës së Pareshit për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa komunës së Parteshit është pranuar sot nga komisioni dhe ka të bëjë me ndarjen e mjeteve shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Bojan Mitic), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa buxhetore e Komunës së Parteshit.

1.25. Shqyrtimi i kërkesës së dytë buxhetore dt. 23.12.2014 të Komunës së Kllokotit-Verbovcit për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se komisioni ka pranuar sot kërkesën e dytë të Komunës së Kllokotit dhe ka të bëjë me ndarjen e mjeteve shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Bojan Mitic), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa e dytë buxhetore dt. 23.12.2014, e Komunës së Kllokotit-Verbovcit.

1.26. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Deputetit Danush Ademi për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa e parashtruar nga deputeti Danush Ademi është për ndarjen e 900,000 eurove për ndërtimin e 90 shtëpive për komitetin ashkalinjë në disa komuna.

Fikrim Damka – disa herë kemi diskutuar për ndarjen e kodeve të veçanta dhe buxhetit për secilin komunitet brenda ministrisë për komunitete dhe kthim. Në vitin 2013 komuniteti turk prej ministrisë për kthim ka marr vetëm 4,000 euro. Kjo ministri mos të identifikohet vetëm me një komunitet, por të ndahen investimet kapitale për të gjithë komunitet njëjtë, ose ti ndërrohet emri ministrisë.

Kryetari - mendojë se duhet të rregullohet çështje e ndarjes së buxhetit, që të specifikohet për secilin komunitet dhe qeveria duhet të gjejë formulën për ndarjen e mjeteve që janë brenda ministrisë. Në emër të komisionit, nëse edhe ju pajtoheni me rastin e miratimit të amendamenteve, në seancë plenare, do të kërkojë që qeveria të rregullojë këtë çështje.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa buxhetore e Deputetit Danush Ademi.

1.27. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Deputetes Duda Balje për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se kërkesa e parashtruar nga deputetja Duda Balje është për ndarjen e 250,000 eurove për ndërtimin e rrugës Restelicë-Stezomir.

Avdullah Hoti, njoftoi se ka biseduar me deputeten Duda Balje dhe janë pajtuar që kjo kërkesë të trajtohet në rishikimin e buxhetit.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet kërkesa buxhetore e Deputetes Duda Balje.

1.28. Shqyrtimi i amendamentit të Grupit Parlamentar 6+ për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari, sqaroi se amendamenti i grupit parlamentar 6+ është i ngjashëm si kërkesa e parashtruar nga deputetja Duda Balje për ndarjen e 250,000 eurove për ndërtimin e rrugës Restelicë-Stezomir.

Pas sqarimeve të amendamentit dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet amendamenti i Grupit Parlamentar 6+.

1.29. Shqyrtimi i amendamentit të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Donika Kadaj-Bujupi – është vendim i qeverisë së kaluar e tash partner në koalicion, e cili është marr me datën 18.03.2014 dhe është nënshkruar me këshillin social-ekonomik të Kosovës dhe ka të bëjë me implementimin e kontratës kolektive, dhe ne konsiderojmë që vendimet e qeverisë duhet të zbatohen dhe qytetarë e Kosovës nuk guxojnë të mashtrohen vetëm për fushata. Qeveria duhet të gjejë burimin e të hyrave për të implementuar këtë vendim, që ka të bëjë me implementimin e kontratës kolektive dhe rritjen e pagave për të gjitha kategoritë që paguhen nga buxheti i Kosovës.

Visar Ymeri – në parim duhet ta krijojmë një kulturë të vazhdimësisë e përgjegjësisë ndaj nënshkrimeve të vendimeve. Implementimi i kontratës kolektive është nënshkruar nga kryeministri dhe qeveria merr obligim me e zbatue. Përndryshe, kjo krijon një mosbesim të qeverisë për nënshkrimet dhe obligimet që i merr qeveria.

Kryetari – duhet të jemi koshient në sistem të funksionimit të shtetit dhe duhet me e pas një kontinuitet të obligimeve. Ne sa kemi bërë një hap në këtë drejtim dhe kemi ndarë për kontratën kolektive një shumë prej 11 milion euro, po në të ardhmen besojë që do të përmbushet në tërësi kjo kontratë.

Latif Gashi – veç dua të rikujtoj se qeveria që shkoj i ka rrit pagat që ka premtuar. Është e vërtetë që ka është marrë një vendim për kontratën kolektive, por besoj edhe në kryeministri aktual gjatë vitit që vjen, në mundësinë e parë do ta shqyrtoj mundësin e rritjes së pagave, dhe jam dakord me parafolësit se vendimet që merren duhet zbatuar.

Pas sqarimeve të amendamentit dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me tetë vota Kundër, dy vota Për (Donika Kadaj-Bujupi dhe Visar Ymeri), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet amendamenti i propozuar nga Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

1.30. Shqyrtimi i amendamentit të deputetit Rrustem Berisha për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - sqaroi se amendamenti i deputetit Rustem Berisha, u diskutuar më herët dhe si komision kemi rekomanduar përkrahjen e pjesërishme të kërkesave. Është përkrahur kërkesa e parë plotësisht për ndarjen e mjeteve për projektin Kompleksi “Beteja e Koshares” për ndarjen e 50,000 euro shtesë, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Për kërkesën e dytë janë përkrahur që të ndahen 200,000 euro për projektin e ri – Vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial “Beteja e Koshares” dhe ky projekt do të vendoset në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale. Ndërsa kërkesa e tretë nuk është përkrahur. Për shkak të teknikës së amendamentimit, ne raportin final duhet shkruar se amendamenti nuk ka përkrahjen e komisionit, ndërkaq unë e sqarojë se cilat projekte dhe në çfarë shume janë përkrahur nga komisioni dhe në cilat amendamente figurojnë.

Pas sqarimeve të amendamentit, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Nuk përkrahet amendamenti ashtu siç është propozuar nga deputeti Rustem Berisha.
2. Kërkesa e parë është përkrahur plotësisht, për ndarjen e mjeteve për projektin Kompleksi “Beteja e Koshares” për ndarjen e 50,000 euro shtesë, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Për kërkesën e dytë janë përkrahur që të ndahen 200,000 euro për projektin e ri – Vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial “Beteja e Koshares” dhe ky projekt do të vendoset në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale. Ndërsa kërkesa e tretë nuk është përkrahur.

1.31. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Bali Muharremi për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Bali Muharremi – sqaroi se me amendamentin që ka propozuar, ka kërkuar të ndahen 400,000 euro për shkollën Vaso Pash Shkodrani në fshatin Leshan-Therandë, për Shtëpinë e Kulturës Ukë Bytyqi në Suharekë 1.5 milion euro, për infrastrukturën në zonën industriale në Suharekë 500,000 euro, për shtëpinë e pleqve në Suharekë 700,000 euro dhe për ndërtimin e rrugës Therandë-Suharekë 1 milion €.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Donika Kadaj-Bujupi), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet amendamenti i deputetit Bali Muharremi.

1.32. Shqyrtimi i pesë amendamenteve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini dhe Sport për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - sqaroi se katër amendamentet e komisionit për arsim, shkencë, teknologji, rini dhe sport, ka të bëjë me shkurtimin e mjeteve për blerjen e automjeteve në Universitetin e Prizrenit, Gjilanit, Gjakovës dhe Mitrovicës dhe transferimin e mjeteve në pajisje për salla dhe laboratorë për studentë. Ndërkaq amendamenti i pestë ka të bëjë me zvogëlimin e mjeteve kapitale prej 400,000 euro nga projekti “Stadiumet ndihmëse të futbollit” dhe transferimi i tyre në projektin “Renovimi i Fazës së II-të të Stadiumit Olimpik Adem Jashari” në Mitrovicë.

Pas sqarimeve të amendamentit, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- I. Nuk përkrahen amendamentet 1,2, 3 dhe 4, të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini dhe Sport.
- II. Përkrahet amendamenti 5 i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini dhe Sport, për zvogëlimin e mjeteve kapitale prej 400,000 euro nga projekti “Stadiumet ndihmëse të futbollit” dhe transferimi i tyre në projektin “Renovimi i Fazës së II-të të Stadiumit Olimpik Adem Jashari” në Mitrovicë.

1.33. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Visar Ymeri për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Visar Ymeri – theksoi se Kuvendi Komunal i Prishtinës, ka miratuar buxhetin për vitin 2015, në vlerë prej 69,091,410 Euro, që ishte rreth 6 milion Euro më i lartë sesa buxheti që parashihej me qarkoren buxhetore 2015/02 për kryeqytetin. Ky buxhet u dorëzua në Ministrinë e Financave, por kjo Ministri, për shkak të tejkalimit të këtyre kufijve, aplikoi nenin 62 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe vendosi buxhetin në vlerë prej 56 milion euro, i cili është i ngjashëm me buxhetin e vitit 2014, duke konsideruar se Kuvendi Komunal i Prishtinës ka dështuar ta dorëzojë buxhetin në pajtim me këtë ligj dhe me qarkoret buxhetore. Mirëpo, ky buxhet është rreth 6 milion Euro më i vogël sesa buxheti i përcaktuar me qarkoret buxhetore për vitin 2015, për shkak se aty është marrë parasysh zvogëlimi i grantit qeveritar për shkak të numrit më të vogël të popullsisë dhe të hyrat vetanake për vitin 2014, e që ishin më të ulta sesa për vitin 2015. Gjithashtu, ky buxhet është rreth 12 milion Euro më i vogël sesa buxheti i miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës për vitin 2015.

Avdullah Hoti - komunat janë të obliguara sipas ligjit të miratojnë buxhetet e tyre dhe në pajtim me kufijtë e përcaktuar në qarkoret buxhetore. Komuna e Prishtinës e ka aprovuar buxhetin brenda afatit kohorë 30 shtator, që ka qenë mbi kufijtë e përcaktuar pasi që ajo planifikon të realizojë me shumë të hyra buxhetore. Nuk ka asnjë problem, në cilin do muaj, në rast se Komuna e Prishtinës mbledh me shumë të hyra vetanake, me aprovimin e komunal, të dërgohet kërkesa në ministrin e financave dhe këto mjete pastaj i barten komunës për shfrytëzim.

Visar Ymeri – ne të gjithë e dimë se mjetet planifikohen për gjithë vitin, madje kjo bëhet edhe me buxhetin e Kosovës, ku planifikohen mjetet, ndërkaq gjatë vitit realizohen të hyrat. Kjo me qëllim të projektet të planifikohen duke u bazuar në mjetet që janë të buxhetuara. Në të kundërtën në rast se nuk ke buxhet, nuk mund ti planifikosh projektet. Ajo çfarë po thoni ju zoti ministër, që Komuna e Prishtinës, muaj për muaj me e ndryshue buxhetin e vetë në bazë të performances së të hyrave, nuk ka kurrfarë logjike.

Avdullah Hoti – kufijtë buxhetor janë përcaktuar në qarkoren buxhetore dhe të gjitha organizatat buxhetore kanë qenë të obliguar të përgatisin buxhetin në përputhje me ata kufi. Nëse nuk respektohen vendoset buxheti e vitit paraprak. Unë po them se teknikisht, asnjë problem nuk është me u realizue planifikimi prej 69 milion euro, në rast se komuna performon me të hyrat e planifikuara.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Visar Ymeri), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet amendamenti i propozuar nga deputetit Visar Ymeri.

1.34. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Faton Topalli për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari – kërkesa është që në ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale të rritet buxheti nga 28 milion në 56 milion euro.

Pas sqarimeve të amendamentit dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me tetë vota Kundër, dy vota Për (Donika Kadaj-Bujupi dhe Visar Ymeri), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet amendamenti i propozuar nga deputetit Faton Topallit.

1.35. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Nait Hasani për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - kërkohej ndarja prej 800,000 euro për një rrugë nga fshati Plane deri te rënia e 40 dëshmorëve në Pashtrik.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Safete Hadergjona), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet amendamenti i propozuar nga deputetit Nait Hasani.

1.36. Shqyrtimi i tre amendamenteve të Deputetit Sali Salihu për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se deputeti Sali Salihu ka propozuar tre amendamente. Amendamenti i parë ka të bëjë me ndarjen e mjeteve për Shkollën e Mesme “Hali Alidema” në Pozhoran në shumë prej 1.5 milion euro. Amendamenti i dytë për ri-asfaltimin e rrugës Viti-Gërlicë prej 1.2 milion euro. Amendamenti i tretë për ri-asfaltimin e rrugës Viti-Klllokot prej 600,000 euro.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Visar Ymeri), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahen tre amendamentet e propozuar nga deputetit Sali Salihu.

1.37. Shqyrtimi i katër amendamenteve të Deputetit Besnik Bislimi për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari- sqaroi se deputeti Besnik Bislimi ka propozuar katër amendamente. Amendamenti i parë ka të bëjë me kërkesën për fshirjen e paragrafit 3 të nenit 10. Amendamenti i dytë për ndarjen e mjeteve prej 1 milion euro për ndërtimin e një shkolle fillore në lagjen Veternik të Komunës së Prishtinës. Amendamenti i tretë t’i alokohen MASHT-it 11.03 milion euro për veprimtari kërkimore shkencore. Amendamenti i katërt të ndahen 2 milion euro, për asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve rurale në fshatrat e brezit kufitar të komunës së Dardanës.

Pas sqarimeve të kërkesës, Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Kundër, një votë Për (Visar Ymeri), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahen katër amendamentet e propozuar nga deputetit Besnik Bislimi.

1.38. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetes Alma Lama për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se deputetja Alma Lama ka propozuar që të ndahen 1,800,000 euro për viktimat e dhunës seksuale të luftës që i kanë mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës 27.02.1998 deri më 20.06.1999. E kemi diskutuar këtë qeshje dhe ka pas mendime të ndryshme dhe unë kam qenë kundër futjes së përhershme të financimit për këtë kategori. Por duhet të realizohen aktivitete të ndryshme të rehabilitimit.

Donika Kadaj-Bujupi - pasojat për jetën e këtyre viktimave janë afatgjata, prandaj veprimet institucionale janë të tilla që konsideroj që duhet të trajtohen sikurse kategoritë të tjera të dalura nga lufta dhe pa asnjë dallim. Ne veç se kemi votuar ligjin dhe prandaj duhet ta zbatojmë atë.

Visar Ymeri - këto diskutime i kemi bërë kur është shqyrtuar ligji, nuk është çështje emocionale por është ligjore dhe institucionale. Pasi që është një çështje ligjore, nuk kemi çka me e diskutu me atë pjesë, përveç se të zbatohet ligji dhe besoj që duhet të përkrahet ky amendament.

Latif Gashi – kemi diskutuar dhe këtë kategori e kemi bërë ligjore. Unë mendoj që e përkrahim idenë që duhet me u bërë një komision qeveritar për me bërë verifikimin e këtyre kategorive dhe me u ditë saktë numri i përfituesve.

Safete Hadergjonaj – më herët kemi diskutuar për zgjidhjen e këtij problemi dhe në fund komisioni për buxhet dhe financa, ka marrë vendim për me e përkrah ligjin dhe kjo kategori me qenë pjesë e ligjit. Në ligj janë të definuar qartë se çfarë hapa duhet të ndërmerren në përcaktimin e përfituesve. Kemi të bëjmë me një çështje të ndishme dhe duhet pasur parasysh, se kjo mund të kalojë në seancë.

Besa Gaxherri - në bazë të ligjit në fuqi, është paraparë që brenda gjashtë muajsh të formohet komisioni qeveritar që merret me këtë kategori, por ende nuk është formuar komisioni. Unë mendoj se duhet me u zbatue ligji dhe kjo kategori të paguhet, sikurse edhe të gjitha kategoritë tjera të luftës.

Kryetari - propozojë që këtë çështje ta rregullojmë duke e plotësuar paragrafin 4 të nenit 12, ku pas fjalës “veteranët e luftës” shtohen fjalët “ dhe viktimave të dhunës seksuale të luftës të cilat i kanë mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës së 27.02.1998 deri më 20.06.1999”. Me këtë propozim ne përmbushim amendamentin e deputetes, por që ne duhet të deklarohejmë se nuk e përkrahim, pasi që nuk kemi shifra, dhe kjo çështje duhet të trajtohet edhe në pajtim me ligjin në fuqi që trajton këtë kategori.

Pas sqarimeve të amendamentit dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Nuk përkrahet amendamenti ashtu siç është propozuar nga deputetja Alma Lama.

2. Komisioni, njëzëri miratoi amendamentin e ri në pjesën tekstuale të Projektligjit, si në vijim: Në nenin 12, në paragrafin 4 pas fjalës “veteranët e luftës” shtohen fjalët “ dhe viktimave të dhunës seksuale të luftës të cilat i kanë mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës së 27.02.1998 deri më 20.06.1999”.

1.39. Shqyrtimi i amendamentit të parë të Grupit Parlamentar Nisma për Kosovën për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se grupit parlamentar Nisma për Kosovën ka propozuar dy amendamente. Me Amendamentin 1 është kërkuar të bëhet ndarja e buxhetit për funksionalizimin e çerdhes ne qytetin e Malishevës për vitin 2015 – 2016 ne shumën prej 57,984 euro.

Pas sqarimeve të amendamentit dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me tetë vota Kundër, dy votë Për (Visar Ymeri dhe Donika Kadaj-Bujupi), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet amendamenti i parë i propozuar nga Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën.

1.40. Shqyrtimi i amendamentit të dytë Grupit Parlamentar Nisma për Kosovën për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari sqaroi se me amendamentin 2 është kërkuar të planifikohet buxheti për vitin shkollor 2014 - 2015 për mësimdhënës të rinj në shkollën fillore dhe të mesme të ultë në fshatin Vërmicë komuna e Malishevës, ne shumën prej 49.680 euro.

Pas sqarimeve të amendamentit dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Nuk përkrahet amendamenti i dytë i propozuar nga Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën.

1.41. Shqyrtimi i propozimeve të Ministrisë së Financave për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Avdullah Hoti - Ministria e Financave, ka rishikuar draft-buxhetin e dërguar në Kuvend, dhe kemi identifikuar disa kursime që i kemi bërë në formë të propozimeve konkrete. Kursimet i kemi bërë për blerjen e veturave nga institucionet qendrore prej 2.8 milion euro. Po ashtu kemi hequr blerjen e kompjuterëve, softuerëve dhe pajisjeve të IT-së për gjashtë muajt e parë dhe kemi kursyer 9.5 milion euro. Po ashtu kursime janë bërë për disa projekte tjera që ende nuk kanë filluar në disa ministri dhe kur duhet përgatitje për leje ndërtimore për projektet përkatëse. Shuma komplet qe ne e kemi kursyer është 14.5 milion euro. Propozimi jonë në qeveri është që këtë shumë të kursyer, ta ndajmë si në vijim: 3 milion për barna esenciale, 1 milion euro për trajtime shëndetësore jashtë vendit, 125,861 euro për Ministrinë pa-portofol, 400,000 euro për Ministrinë e ambientit për projektin Parku Memorial “Ibrahim Rugova” në Istog, 400,000 euro për kthim për komunitete. Shuma tjetër qe mbetet prej 9,577,60 , së bashku me pjesën tjetër të mjeteve të ministrisë së financave prej 1,559,500 euro të ndahet si kontigjencë për paga, për të filluar pagesën e përvojës së punës prej 0.5% , posa të kompletohet dokumentacioni i të gjithë të punësuarve publik. Të gjitha këto i kemi përgatit në formë të propozimeve konkrete dhe kërkojmë nga komisioni që ti përkrah.

Visar Ymeri – theksoi se është dakord me kursimet dhe dakord me disa alokime, por jo me të gjitha siç janë në pako, sepse dallojnë në natyrë dhe në qëllim. Për këtë arsye jam kundër propozimit.

Kryetari – kërkoi nga anëtarët të deklarohen për propozimet për kursime të bëra nga ministri i financave në diskutimin më lartë.

Pas propozimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni, me tetë vota Për, dy Kundër (Visar Ymeri dhe Donika Kadaj-Bujupi), nxori këtë:

Përfundim

Përkrahen propozimet e Ministrisë së Financave, për shkurtimet dhe transferimet e brendshme në pjesën tabelare të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015. Propozimet e Ministrisë, bëhen amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa, dhe janë pjesë e Raporti me amendamentet të Komisioni, që procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani